

REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVËS	
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	
MINISTRI I ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	
SEKTORI I ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	
Njësia Org.	013
Org. Jedishtes	5035
Org. Unit	
Nr. i faqeve	17, 12, 11
Bi-stranica	
No. pages	
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku
i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology**

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 17 dhjetor 2015
Ref. nr: 404/013

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të dispozitave të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 82 të datës 21 tetor 2010), dispozitat e nenit 8, paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011), si dhe duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore dhe Programin Kombëtar të Shkencës 2010-2015, merr këtë:


V E N D I M

- I. Për ndarjen e çmimit vjetor "Shkencëtar i Vitit" 2015 për rezultate të jashtëzakonshme kërkimore-shkencore përgjatë periudhës njëvjeçare, për tre shkencëtarët në këtë përbërje, sipas radhitjes alfabetike:
 - Prof. Asoc. Dr. Avdulla ALIJA, Departamenti i Biologjisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".
 - Prof. Ass. Dr. Avni BERISHA, Departamenti i Kimisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".
 - Prof. Ass. Dr. Halil IBRAHIMI, Departamenti i Biologjisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".

- II. Për ndarjen e çmimit vjetor "Shkencëtar i Ri i Vitit" 2015 për rezultate dhe potenciale të larta kërkimore-shkencore përgjatë periudhës njëvjeçare, për tre shkencëtarët e rinj në këtë përbërje, sipas radhitjes alfabetike:
 - Armond DACI, kandidat doktorant, bashkëpunëtor shkencor, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".
 - Pranvera IBRAHIMI, doktorant, bashkëpunëtoreshkencore, Departamenti i Shëndetit Publik dhe Mjekësisë Klinike, Universitetit Umeå.
 - Valmir KRASNIQI, bashkëpunëtor shkencor, Departamenti i Matematikës, FSHMN, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".

- III. Kandidatët e përcaktuar në pikën I të këtij vendimi, janë përfitues të çmimit në vlerë nga €2000.
- IV. Kandidatët e përcaktuar në pikën II të këtij vendimi, janë përfitues të çmimit në vlerë nga €1500.
- V. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i MASHT për zbatimin e këtij vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- VI. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Prof. Dr. Arsim BAJRAMI, *Ministër*



Iu dërgohet:

- Të gjithë përfituesve të çmimeve sipas pikës I dhe II të këtij vendimi;
- Këshillit Shkencor të MASHT;
- Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
- Departamentit të Shkencës dhe Teknologjisë të MASHT;
- Arkivit, MASHT.